


Taksat e Mjedisit në Shqipëri 2019

Tiranë, më 16 Korrik 2021: Në 2019, të ardhurat nga taksat mjedisore arritën në vlerën e rreth 53 miliardë lekë¹, duke u rritur me 4,44 %, krahasuar me vitin 2018. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga rritja e të ardhurave nga taksat e energjisë (**Tab. 1**).

Fig. 1 Pesha që zënë të ardhurat e taksave mjedisore ndaj taksave gjithsej dhe kontributeve shoqërore dhe PBB-së



¹ Si rrjedhojë e rishikimeve të sistemit të klasifikimit të taksave, në publikimin e këtij viti është revizionuar e gjithë seria kohore e Taksave Mjedisore në Shqipëri. Të gjitha revizionimet janë të shpjeguara në seksionin "Metodologjia" të këtij publikimi dhe janë në përputhje me politikat e revizionimit statistikor http://instat.gov.al/media/2829/politika_e_revizionimit.pdf.

Tab. 1 Të ardhurat nga taksat mjedisore sipas llojeve (milionë lekë)

	2015	2016	2017	2018	2019
Taksat e Energjisë	37.741	40.946	40.400	43.522	45.165
Taksat e Transportit	4.437	4.936	5.145	5.342	5.567
Taksat e Ndotjes	1.782	1.880	1.941	2.226	2.625
Taksat e Burimeve Natyrore	33	52	62	56	59
Gjithsej	43.993	47.813	47.549	51.146	53.416

Nga struktura e të ardhurave të taksave mjedisore për vitin 2019, taksat e energjisë zënë pjesën më të madhe të të ardhurave me 84,55 %, pasuar nga taksat e transportit 10,42 %, taksat e ndotjes me 4,91 % dhe taksat e burimeve natyrore me 0,11 %.

Gjatë vitit 2019, të ardhurat nga taksat e ndotjes janë rritur me 17,91 %, ndërkohë që të ardhurat nga taksat e burimeve natyrore janë rritur me 4,94 %. Gjatë së njëjtës periudhë, të ardhurat nga taksat e transportit janë rritur me 4,21 %, kurse të ardhurat nga taksat e energjisë janë rritur me 3,78 % (**Tab. 2**).

Tab. 2 Struktura e të ardhurave nga taksat mjedisore sipas llojeve (%)

	2015	2016	2017	2018	2019
Taksat e Energjisë	85,79	85,64	84,97	85,09	84,55
Taksat e transportit	10,09	10,32	10,82	10,44	10,42
Taksat e Ndotjes	4,05	3,93	4,08	4,35	4,91
Taksat e BurimeveNatyrore	0,07	0,11	0,13	0,11	0,11

Në 2019, pesha e të ardhurave nga taksat mjedisore ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) është 3,16 %, duke pësuar një rritje me 0,04 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2018.

Të ardhurat nga taksat mjedisore, në vitin 2019, përbëjnë 12,53 % të të ardhurave tatimore gjithsej dhe kontributeve shoqërore duke pësuar një rritje me 0,33 pikë përqindje, krahasuar me 2018 (**Tab. 3**).

Tab. 3 Të ardhurat tatimore mjedisore (%)

	2015	2016	2017	2018	2019*
Pesha që zënë të ardhurat e taksave mjedisore ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto(PBB)	3,07	3,25	3,07	3,12	3,16
Pesha që zënë të ardhurat e taksave mjedisore ndaj taksave gjithsej dhe kontributeve shoqërore	12,85	12,93	11,93	12,20	12,53

2019* Të dhëna gjysmë-finale të PBB -së

Metodologjia

Gjatë vitit 2020, INSTAT ka kryer revizionime të klasifikimit të taksave në përputhje me politikat e revizionimit statistikor (http://instat.gov.al/media/2829/politika_e_revizionimit.pdf). Si rezultat i këtyre revizionimeve u pa i nevojshëm rishikimi i të gjithë serisë kohore të Taksave të Mjedisit. Ndryshimet në Taksat e Mjedisit kanë ardhur si pasojë e riklasifikimeve të disa taksave si më poshtë:

- 1- Klasifikimi i dy prej taksave që ndikojnë mbi mjedisin dhe përfshirja e tyre si pjesë e taksave të ndotjes dhe të burimeve natyrore.
- 2- Riklasifikimi i një prej taksave që ka ndikim mbi mjedisin, nga Taksë Transporti në Taksë Energjie, e përdorur për qëllime transporti

Këto ndryshime janë reflektuar në të gjithë serinë kohore të taksave mjedisore të publikuar në faqen e INSTAT dhe në databazën statistikore, si dhe shpjegohen në seksionin “Metodologjia” të kësaj faqeje.

Përkufizime

Llogaritë e taksave të lidhura me mjedisin

Taksat mjedisore konsiderohen si një instrument ekonomik për të kontrolluar ndotjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore dhe ato janë konceptuar për të ndikuar në sjelljen e bizneseve, prodhuesve dhe konsumatoreve. Taksat mjedisore janë pjesë e llogarive ekonomike në mjedis, pjesë e një sistemi satelitor të Llogarive Kombëtare.

Të dhënat e taksave mjedisore janë siguruar nga Ministria e Financës. Të dhënat e taksave mjedisore janë subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: http://instat.gov.al/media/2829/politika_e_revizionimit.pdf

Mëposhtë paraqiten përkufizimet e katër grupeve kryesore të taksave të mjedisit:

1. Taksat e energjisë

Taksat e energjisë (duke përfshirë karburantin e makinave) përfshijnë taksat mbi prodhimet e energjisë në vend, si dhe prodhimet e energjisë që përdoren edhe për qëllime të transportit. Këtu përfshihen edhe tatimet mbi bio-karburantet dhe format e tjera të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe taksat mbi rezervat e produkteve të energjisë.

2. Taksat e Transportit

Taksat e transportit (me përjashtim karburantin e makinave) i referohen kryesisht taksave të lidhura me pronësinë dhe përdorimin e automjeteve. Këto taksa përfshijnë edhe taksat mbi mjetet e tjera të transportit (si avionët, anijet dhe trenat, etj) dhe shërbimet e tyre.

3. Taksat e Ndotjes

Taksat e ndotjes përfshijnë emetimet e matura në ajër dhe shkarkimet në ujë, menaxhim të mbetjeve të ngurta dhe zhurmës etj. Përfshihen këtu tatimi mbi emetimin e CO₂, i cili mbulohet nga kategoria taksave të energjisë.

4. Taksat e Burimeve Natyrore

Taksat e burimeve natyrore përfshijnë taksat për nxjerrjen apo shfrytëzimin e burimeve natyrore (ujë, pyje, kafshë të egra, etj).

TVSH dhe taksat e tjera nuk përfaqësojnë një taksë me ndikim direkt parandalues ose frenues të produkteve që dëmtojnë mjedisin, si dhe nuk përdoret në formë ekskluzive për mbrojtjen e mjedisit. Si rezultat këto taksa janë të përjashtuara nga këto vlerësime.

Lista kombëtare e taksave paraqet pikënisje për vlerësimin e të ardhurave nga taksat mjedisore. Metodologjia e përdorur për llogaritjen e tyre është bërë në përputhje me Rregulloren (BE) Nr 691/2011 dhe udhëzimet e Eurostat: "Taksat mjedisore, një udhëzues statistikor". Këto të dhëna janë të harmonizuara me Sistemin Evropian të Llogarive Ekonomike (ESA 2010).